



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 27.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 24.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Taxi Bujar Stublla" për aktivitetin :"**Transporti i nxenseve dhe arsimitareve**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1046-221 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "Auto taxi Bujar Stublla" e datës 24.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Transporti i nxenseve dhe arsimitareve**", me Nr.616 19 1046 221, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së lidhur me anulimin e aktivitetit për linjen 4;
2. Vërtetohet Vendimi për anulim ;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Auto Taxi Bujar stublla " me datë 24.05.2019 ka parashtruar kerkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"**Transporti i nxenseve dhe arsimitareve**".

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.05.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me anulimin e aktivitetit për linjen 4 dhe me trajtimin e tenderit të tij si i pa përgjegjshëm,por pa argumentuar pretendimet e tij

-I njejtë pretendon se ka mjetin e kerkuar-kombi me tete ulese,por te njejtë i eshte sqaruar se bazuar ne dipozitatat ligjore te Ligjit per rregullat e trafikut rrugor,automjeti qe e posedon nuk

hyn ne kategorine e automjeteve te udhetareve,pasiqe per tu kategorizuar nje mjet si i tille duhet qe pos uleses se vozitesit te kete me shume se tete(8)ulese(neni 3.1.8);  
-Pretendimi tjeter per posedimin e lejes se vozitjes poashtu nderlidhet me kastegorizimin e mjeteve dhe rezulton te mos kete leje adekuate.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit